



BASHKIA MALLAKASTËR

RAPORTI I MONITORIMI TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2018



PËRMBAJTJE

1. HYRJE.....	2
2. VIZIONI DHE DREJTIMET STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT LOKAL.....	3
3. MONITORIMI I BUXHETI PER VITIN 2018.....	6
4. MONITORIMI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2018.....	8
5. MONITORIMI I INVESTIMEVE PER VITIN 2018.....	15
6. MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE.....	19



1. Hyrje

1.1. Përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit

Ky raport ndihmon për monitorimin e zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, për produktet dhe objektivat e politikës të realizuara për çdo program. Monitorimi është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet treguesve faktikë të performances me ato të planifikuar. Gjithashtu monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Programet e shpenzimeve monitorohen për të siguruar transparencë në lidhje me performancën e tyre. Treguesit e monitorimit të performancës duhet të jenë:

- Lehtësisht të kuptueshëm;
- Specifik dhe të lidhur ngushtë me qëllimin e politikës së programit dhe objektivat që synohen të arrihen përmes tij;
- Lehtësisht të matshëm;
- Të identifikueshëm

Bashkia Mallakastër gjatë vitit 2018 ka funksionuar me 16 programe buxhetore si më poshtë:

- ✓ Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi
- ✓ Sherbimi i kujdesit Social
- ✓ Sherbimi Mbrojtja ndaj Zjarrit
- ✓ Menaxhimi i Ifrasktuktures se Ujitjes dhe Kullimit
- ✓ Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave
- ✓ Mbimbajtja e rrugeve
- ✓ Ndriçimi Publik
- ✓ Pastrim Gjelberimi
- ✓ Ujsjelles Kanalizime vendore
- ✓ Zhvillimi i sportit
- ✓ Zhvillimi i kultures
- ✓ Arsimit parashkollor
- ✓ Arsimit parauniversitar
- ✓ Sherbimi i gjendjes civile
- ✓ Ndihma ekonomike
- ✓ Paaftesia



2. VIZIONI DHE DREJTIMET STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT LOKAL

Zhvillimi i ekonomisë dhe i një shoqërie gjithëpërfshirëse që ofron oportunitete dhe mirëqenie për të gjithë banorët e Bashkisë Mallakaster.

I. DREJTIMI STRATEGJIK 1

Zhvillimi dhe diversifikimi i ekonomisë lokale mbështetur në një program të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit bazuar në dy sektorë prioritarë të zhvillimit: Zhvillimi i biznesit dhe zhvillimi rural.

OBJEKTIVAT

- Integrimi i zonave rurale me ato urbane duke garantuar infrastrukturë dhe shërbime publike cilësore sipas standarteve.
- Promovimi i vlerave ekonomike dhe prodhimit lokal
- Krijimi i bazës së integruar të asetëve territoriale, hartimi i një plani të menaxhimit të asetëve publike të Bashkisë përfshirë dhe asetet jo-publike.
- Rritja e punësimit me vemendje dhe punësimin e të rinjve, të femrave dhe personave nga shtresat në nevojë.

NEN-DREJTIME STRATEGJIKE

- Zhvillimi rural
 - Rehabilitimi dhe zhvillimi i rrjetit kullues
 - Të menaxhohen dhe fuqizohen mjetet për sistemin kullues
 - Të sigurohet mirembajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të kanaleve kullues.
- Rehabilitimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së ujitjes
 - Vënia në funksionim i stacioneve të pompimit
 - Shfrytëzimi i burimeve ujore për të siguruar vaditjen e nevojshme të gjithë sipërfaqes së tokës bujqësore.
- Mbeshtetje fermerëve për:
 - Zhvillimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve të mbrojtura (serave) për prodhimin e perimeve.
 - Permiresimit të infrastrukturës për të mundësuar nxitjen e kooperimit për krijimin e fermave private me 5 deri 10 ha për një bujqesi intensive.
 - Shtimin e sipërfaqeve të mbjella me ullishte.
 - Përdorimin e pesticideve.
 - Informimit për kredimin e fermerëve nga banka dhe instrumenta të tjerë financimi dhe subvencionimi.
- Mbeshtetje për zhvillimin e biznesit për:
 - Industrinë fason
 - Agro-perpunimin
 - Krijimi i zonave të përshtatshme ekonomike me infrastrukturën e nevojshme.
 - Hapja e një qendre biznesi, krijimi i një portali informativ për biznesin lokal (opsional)
 - Mbeshtetje të rinjve (dhe femrave) sipërmarrese duan të hapin një biznes të ri.



II. DREJTIMI STRATEGJIK 2

Permiresimi dhe zhvillimi i infrastruktures sociale – zhvillimi i arsimit dhe institucioneve arsimore, permiresimi i sherbimit shendetesor dhe kujdesit social dhe rivitalizimit te jetes kultures dhe sportive.

OBJEKTIVAT

- Te siguroje qe te gjithë femijet parashkollore te marrin sherbimin e kontrollit shendetesor dhe imunitar
- Te gjithë femijet e moshes 5 vjeçare te kene akses ne sherbimin e arsimit parashkollor.
- Te rritet numri i nxënësve që përfitojnë nga kabinete të plotësuar.
- Përmirësimi i infrastrukturës se shkollave dhe mirembajtjes se tyre.
- Te sigurohet 100% perfundimi i arsimit te detyrueshem ne 2021
- Mbeshtetja e nxenesve dhe studenteve te ekselences.

NEN-DREJTIME STRATEGJIKE

- Rehabilitimi i spitalit dhe qendrave shendetesore me probleme
- Permiresimi i institucioneve te arsimit
 - Permiresimi i infrastruktures se shkollave me problem
 - Permiresimi i bazeve materiale, laboratoreve per te rritur cilesine e arsimit dhe transformimin e shkollave ne qendra komunitare.
 - Shtimi i kendeve sportive dhe permiresimi i infrastruktures se palestrave dhe oborreve te shkollave te tjera.
- Mbeshtetje per punesim dhe trajnim profesional ne bashkepunim me Zyren Rajonale te Punes.
- Mbeshtetje ne organizimin e veprimtarite historike dhe edukative kushtuar ngjarjeve dhe figurave te rendesishme lokale.

INFRASTRUKTURA SOCIALE

Qytetari eshte ne qender te vemendjes dhe objektivat per permiresimin e sherbimeve te kujdesit social te ofruar nga Bashkia perfshijne:

- Rikonstruksioni dhe revitalizimi i Qendres se Kultures te qytetit
- Sigurimin e nje sherbimi publik te pergjegjshem ndaj PAK, personave qe trajtohen me ndihme ekonomike dhe familjeve ne nevoje, sigurimin e aksesit ne ndertesat, institucione te ndryshme, ndertimi i rampave ne rruge, trotuare per PAK.
- Bashkeveprimi me OJF-te lokale per ofrimin e sherbimeve sociale (dhenia e sherbimeve ditore), mbeshtetje sociale per integrimin e femijeve nga familje ne nevoje, grate viktime te dhunes, komunitetit rome (dhe organizimi i aktiviteteve kreative dhe sportive) per integrimin e tyre.



III. DREJTIMI STRATEGJIK 3

Menaxhimi i Zhvillimit te Integruar te Territorit - Permiresimi dhe zhvillimi i infrastruktures

PLANIFIKIMI PER ZHVILLIMIN URBAN

- Hartimi i planit per zhvillimin e integruar te territorit nepermjet zbatimit te ligjeve dhe hartimit te planeve rregulluese.
- Rikualifikimi urban i hyrjes dhe qendres se qytetit te Ballshit
- Shtimi i siperfaqes se gjelber (dhe mbjellja e pemeve).

INFRASTRUKTURA RRUGORE

- Përmirësimi i infrastruktures rrugore nderurbane.
- Permiresimi i rrjetit rrugor urban brenda qendrave te banuara te lagjeve te Bashkise, permiresimi i ndriçimit te rrugeve dhe i rrjetit te domosdoshem inxhinierik (ujesjelles, Kanalizime, rrjetet kabllore, etj).
- Sigurimi i mirembajtjes se infrastruktures rrugore kryesore dhe dytesore (ndertimi i korsive te biçikletave).
- Sigurimi i nje transporti publik cilesor per banoret ne te gjitha zonat e reja te shtuara te Bashkise.
- Menaxhimi i mire i mbetjeve urbane dhe jourbane.
- Planifikimi i mjeteve dhe burimeve per pastrimin e qytetit dhe grumbullimin e diferencuar te mbetjeve.
- Nxitja e ndergjegjesimit qytetar per te ulur ndotjen mjedisore.

IV. DREJTIMI STRATEGJIK 4 - ADMINISTRATA PUBLIKE


- Forcimi e kapaciteteve administrative dhe teknike te Bashkise, zhvillimi i sistemeve te teknologjise se informacionit.
- Permiresimi i sherbimit te taksave vendore, rritja e te ardhurave te veta per te rritur financimin ne projekte zhvillimi.
- Permiresimi i sherbimeve publike ndaj qytetareve nepermjet ngritjes se qendrave one-stop-shop.
- Te realizohet procesi i rregjistrimit te pronave nepermjet rritjes se bashkepunimit me ZVRPP.
- Promovimi i aktiviteteve te Bashkise dhe vlerave te rajonit ne nivel kombetar nepermjet zhvillimit dhe mirembajtjes se portalit te Bashkise.
- Zhvillimi i kapaciteteve njerezore te Bashkise nepermjet zbatimit te ligjit te Nepunesit Civil, dhe permiresimi i kapacitetet profesionale (teknike) nepermjet trajnimeve te vazhdueshme.



3. MONITORIMI I BUXHETI PER VITIN 2018

Planifikimi është bërë mbi bazën e politikave programore dhe funksionale me tregues sasiore të monitorueshëm në çdo kohë gjatë procesit të zbatimit dhe realizimit nga çdokush si nga administrata vendore, këshilltarët, shoqëria civile si dhe nga qytetarët.

Grafiku: Realizimi i te ardhurave ne total per vitin 2018




Për vitin 2018 të ardhurat në total të bashkisë nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë rreth **1.199 milionë lekë**. Të ardhurat të pasqyruara në buxhetin e bashkisë ndahen në tre grupe kryesore:

- a) Të ardhurat e veta
- b) Transfertat
- c) Të ardhura të trashëguara

Burimet e veta siç mund të jenë të ardhurat tatimore dhe jotatimore të bashkisë arrijnë në vlerën prej **322 milionë lekë** duke përbër **27 %** e të ardhurave të buxhetit **56 %** e të ardhurave nga transferat e buxhetit qendror me vlerë totale prej **674 milionë lekë** dhe pjesa e mbetur **17 %** janë të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm buxhetor me vlerë totale prej **201 milionë lekë**.

Tabela: Monitorimi i realizimit te te ardhurave te veta ne total per vitin 2018 Plan-Fakt
000/leke

Nr	Emertimi i të Ardhurave	Plan 2018	Fakt 2018	%
A	Te ardhurat e veta	336,716	322,925	96




Planifikimi i të ardhurave të veta është realizuar 96 % si proces në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me njësitë administrative, me institucionet dhe agjentët tatimor, etj. Planifikimi është bërë me pritshmërinë e kryerjes së pagesave të vitit paraardhës dhe sidomos nga pritshmëria e kryerjes së detyrimeve të prapambetura dhe të vitit nga kompanitë e hidrikarbureve nga të cilat tre kompani që kanë dhe detyrime të konsiderueshme ndaj Bashkisë Mallakastër sic është Armo sh.a, Albpetrol sh.a dhe Trasatlantik nuk kanë kryer pagesat sipas parashikimeve të bëra nga ana jonë.

Një tjetër faktor që ka ndikuar në këtë performancë është dhe niveli i lartë i pagesave për detyrimet për tokën bujqesore dhe tarifën familjare. Gjë për të cilën janë nxjerë dhe përpunuar listat emërore të familjarëve që kanë pa likuajduar taksat dhe tarifën vendore, ku një rol kryesor në arkëtimin e këtyre të ardhurave do të këtë Ndërmarja e Ujshjellës Kanalizimeve sh.a me të cilën jemi duke punuar për futjen në faturën mujore të ujit dhe tarifën familjare, duke filluar nga qyteti i Ballshit dhe Njësia Administrative Fratar dhe më pas në të gjitha njësitë e tjera.

Tabela: Monitorimi i realizimit të Taksave-Tarifave për vitin 2018 Plan-Fakt
000/ lekë

<i>Emertimi i të Ardhurave</i>	<i>Plan 2018</i>	<i>Fakt 2018</i>	<i>%</i>
<i>Të ardhura nga taksat</i>	<i>137,974</i>	<i>121,258</i>	<i>88</i>
<i>Të ardhura nga tarifën</i>	<i>183,665</i>	<i>174,118</i>	<i>95</i>





4. MONITORIMI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2018

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik - Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve përfaqëson klasifikimin e transaksioneve të kryera nga pushteti vendor, sipas natyrës ekonomike. Pra klasifikimi ekonomik i buxhetit kategorizon llojet e shpenzimeve të bëra nga pushteti lokal, shumica e të cilave bëhen në administrimin e përditshëm. Zërat përbërëse të klasifikimit ekonomik janë të klasifikuar si më poshtë vijojnë :

- Paga – Artikulli 600
- Sigurime Shoqërore- Artikulli 601
- Shpenzime Operative- Artikulli 602
- Transferta- Artikulli 604-651
- Investime- Artikulli 231

Tabela: Monitorimi i realizimi të shpenzimeve në total sipas artikujve për vitin 2018

Në lekë



Art.	Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	%
600	Paga	205,361,198	192,761,992	12,599,206	94
601	Sigurime Shoqërore	34,657,504	33,178,870	1,478,634	96
602	Mallra dhe shërbime të tjera	199,454,160	80,216,569	119,237,591	40
604	Transferta Korente të Brendshme	6,451,466	1,162,283	5,289,183	18
606	Transferta për Buxh. Fam & Individ	217,970,000	210,019,198	7,950,802	96
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	663,894,328	517,338,912	146,555,416	78
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,040,000	863,636	3,176,364	21
231	Kapitale të Trupëzuara	545,726,379	333,605,062	212,121,317	61
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale	549,766,379	334,468,698	215,297,681	61
	TOTALI	1,213,660,707	851,807,610	361,853,097	70



Tabela: Monitorimi i realizimi të shpenzimeve për vitin 2018

000/lekë

Institucioni	Plani 2018	Realizimi 2018	%
Totali GRANTI	176,369	127,615	72
Totali TRASFERTA SPECIFIKE	108,485	98,654	91
Totali nga te Ardhurat e veta	524,691	223,504	43
Totali Funksione te deleguara	404,114	402,035	99
Shuma:	1,213,659	851,808	70



Shuma prej **852** milionë lekësh është përdorur për përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve të mëposhtme:

- Administratën vendore;
- Emergjencat civile;
- Planifikimin, administrimin dhe kontrollin e territorit;



- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;
 - Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane;
 - Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike;
 - Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm;
 - Mbledhjen, trajtimin dhe transmetimin e ujërave të ndotura;
 - Mbledhjen dhe largimin e ujërave sipërfaqësore të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara;
 - Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit;
 - Shërbimin e dekorit publik;
 - Ndriçimin e mjediseve publike;
 - Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal;
 - Mbështetjen e zhvillimit të biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vendet publike;
 - Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj;
 - Zhvillimin e turizmit;
 - Administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes e kullimit të tokave si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni;
 - Administrimin e sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore;
 - Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit, këshillimit bujqësor e rural, dhe hartimin e statistikave bujqësore vendore;
 - Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit parashkollor (kopshte e çerdhe) dhe parauniversitar;
 - Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehim social;
 - Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, dhe të moshuarit etj;
 - Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;
 - Organizimin e aktiviteteve kulturore, promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;
 - Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve;
 - Programe dhe projekte rinore;
 - Organizimin e aktiviteteve sportive, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve dhe të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.



Tabela : Monitorimi i realizimi të shpenzimeve për vitin 2018 nga transferta e pakushtëzuar
000/lekë

Institucioni	Plani 2018	Realizimi 2018	%
Administrata	115,756	102,938	89
Sherbimi Cerdhe Kopesht	2,800	2,707	97
Sherbimi I kujdesit Social	800	731	91
Ndriçimi Publik	2,805	748	27
Pastrim Gjelberimi	11,590	4,775	41
Ujsjelles Kanalizime vendore	96	0	0
Zhvillimi I sportit	10,800	10,483	97
Zhvillimi I kultures	1,219	266	22
Arsimi baze	1,512	0	0
Mbirmbajtja e rrugeve	28,991	4,967	17
Totali GRANTI	176,369	127,615	72






Tabela : Monitorimi i realizimi të shpenzimeve për vitin 2018 Realizimi i shpenzimeve për vitin 2018 nga transferta specifike

000/leke

Institucioni	Plani 2018	Realizimi 2018	%
Arsimi parashkollor	71,836	67,644	94
Arsimi parauniversitar	12,612	11,656	92
Ujitja dhe kullimi	3,450	2,435	71
Rruget rurale	8,067	6,167	76
Mbrojtja nga zjarri	9,213	8,396	91
Administrimi I pyjeve	3,307	2,356	71
Totali TRASFERTA SPECIFIKE	108,485	98,654	91






Tabela: Monitorimi i realizimi të shpenzimeve për vitin 2018 nga të ardhurat vendore

000/leke

Institucioni	Plani 2018	Realizimi 2018	%
Administrata	102,805	50,570	49
Sherbimi Cerdhe Kopesht	5,944	5,634	95
Mbrojtja ndaj Zjarrit	7,318	18	0
Sherbimi I kujdesit Social	1,320	154	12
Ujitja Kullimi	3,975	863	22
Administrimi I Pyjeve	8,018	4,859	61
Mbimbajtja e rrugeve	245,307	86,793	35
Ndriçimi Publik	29,889	6,374	21
Pastrim Gjelberimi	26,809	19,598	73
Ujsjelles Kanalizime vendore	6,418	3,756	59
Zhvillimi I sportit	46,769	29,676	63
Zhvillimi I kultures	20,436	2,541	12
Arsimi baze	18,906	12,668	67
Arsimi I mesem	777	0	0
Totali shp nga te Ardhurat	524,691	223,504	43

Realizimi i shpenzimeve për periudhën vitin 2018 nga të ardhurat vendore







Tabela: Monitorimi i realizimi të shpenzimeve për vitin 2018 nga funksione të deleguara
000/leke

Institucioni	Plani 2018	Realizimi 2018	%
Sherbimi I gjendjes civile	5,447	5,447	100
Ndihma ekonomike	45,925	45,925	100
Paaftesia	162,370	162,370	100
Pagese nga F.rezerve I Qeverise	951	951	100
Investime G.K ne Ujshelles-Kanalizime	66,734	66,734	100
Investime G.K ne Shkolla	29,697	27,619	93
Investime G.K ne Rik Urban	92,990	92,989	100
Totali Funksione te deleguara	404,114	402,035	99






5. MONITORIMI I INVESTIMEVE PER VITIN 2018

Investimet e realizuara nga Bashkia Mallakastër për vitin 2018 janë realizuar sipas prioriteteve që Bashkia ka patur për vitin 2018 e kushtëzuar kjo dhe nga të ardhurat e realizuara dhe transfertës së pa kushtëzuar të dhënë nga Qeveria Shqiptare.

Totali i investimeve për vitin 2018 është në vlerën **334 milionë lekë** nga të cilat investime të realizuara nga fondet të deleguara janë në shifrën **192 milionë lekë** të cilat i përkasin projekteve që janë për vitin 2018 dhe projekteve të cilat kanë qënë të çelura nga vitet e mëparëshme dhe që janë likujduar gjatë vitit 2018, **1 milionë lekë** investime janë realizuara nga financime të huaja dhe **139 milionë lekë** investime janë realizuara nga fondet e Bashkisë Mallakastër, realizuar nga taksat dhe tarifat e vitit 2018. Siç paraqiten dhe në tabelën e më poshtme.

Tabela: Monitorimi i investimet ne total Plan -Fakt per vitn 2018

<i>Burimit te financimit</i>	<i>2018</i>		
	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>%</i>
Investime nga fonde te deleguara	237,918	192,744	81
Investime nga te ardhurat e veta	269,165	139,420	52
Investime nga financime te huaja	1,442	1,442	100
Investime gjithsej	508,525	333,606	66





Nga kontrollet e kryera nga punonjësit e sektorit të tatim taksave është punuar për ndërgjegjësimin e personave të cilët kërkojnë të hapin biznese të reja, duke i njohur me detyrimin ligjor për rregjistrimin e tyre në QKB dhe detyrimet për taksat dhe tarifave vendore që aplikohen në territorin e Bashkisë Mallakastër. Për realizimin e objektivave për rritjen e të ardhurave, puna do të përqendrohet në mbledhjen e taksave dhe tarifave familjare, për të cilën në bashkëpunim me ujsjellsin Mallakastër do të kryhet faturimi dhe arkëtimi i këtyre detyrimeve të vitit në vazhdim dhe të detyrimeve të prapambetura në secilën familje ku ofrohen shërbimet nga Bashkia Mallakastër.

Tabela: Monitorimi i realizimit të investimeve për vitin 2018

Në lekë

Nr	Emertimi I objektit sipas burimit te financimit	Investitori	Realizimi ne periudhen raportuese		
			Plan	Fakt	%
I	Investime gjithsej(A+B+C)		508,524,538	333,605,062	66
A	Fonde te deleguara		237,917,787	192,743,674	81
1	Rehabilitim I rretit ujtes rezervuari Corrush	Qeveria Shqiptare	5,401,691	5,401,691	100
2	Rikonstruksion Shkolla Bejar	Qeveria Shqiptare	423,423	423,423	100
3	Ndertim KUZ lagja Bylis	Qeveria Shqiptare	33,428,583	33,428,583	100
4	Rikualifikimi Urban lagja 28 Nentori	FZHR	92,989,184	92,989,184	100
5	Ndertim linja e jashteme ujsjellesi Rajonal Mallakaster	Qeveria Shqiptare	32,468,662	32,468,662	100
6	Mbikqyrje Objekti:Ndertim KUZ lagja Bylis	Qeveria Shqiptare	744,754	744,754	100
7	Mbikqyrje objekti:Ndertim linja e jashteme ujsjellesi Rajonal Mallakaster	Qeveria Shqiptare	91,836	91,836	100
8	RIKONSTRUKSION I SHKOLLES "BESLIDHJA"	Qeveria Shqiptare	72,369,654	27,195,541	38
	Investime nga te ardhurat e veta		269,165,005	139,419,642	52
1	Traktor me zinxhire	Bashkia Mallakaster	1,980,000	1,980,000	100
2	Autofshirese	Bashkia Mallakaster	1,482,000	1,482,000	100
3	Kazan Plehrash	Bashkia Mallakaster	2,112,960	2,112,960	100
4	Rikonstuksion rruga:Qender Ballsh-Rruga e Drenoves	Bashkia Mallakaster	1,600,466	1,600,466	100
5	Autobot uji	Bashkia Mallakaster	2,970,000	2,970,000	100
6	Kamjonçine me kosh profesional	Bashkia Mallakaster	2,160,000	2,160,000	100



7	Rehabilitim i parkut te lojrave per femije dhe fushes sportit	Bashkia Mallakaster	28,064,389	28,064,389	100
8	Shtrese tapeti I rrugeve te lagjes Bylis,te bulevardit qendror deri te shkolla "Odisea"si dhe ndertim trotuare dhe bordura ne rruget e lagjes "Bylis"	Bashkia Mallakaster	63,366,826	36,432,682	57
9	Blerje kompjutera	Bashkia Mallakaster	1,921,800	1,921,800	100
10	Instalim sistemi i cekimit,fonise per dy salla,sistemi I suvrejimit dhe centrali I telefonise	Bashkia Mallakaster	4,808,040	4,808,040	100
11	Rikonstruksion dhe shtese kati ndertesa e Bashkise	Bashkia Mallakaster	16,446,515	16,446,515	100
12	Kolaudim objekti:Rehabilitim i rretit ujites Kute	Bashkia Mallakaster	33,960	33,960	100
13	Kolaudim objekti:Rikonstruksion I rrugeve ne fshatra	Bashkia Mallakaster	22,320	22,320	100
14	Mbykqyrje punimesh: reabilitimi ii parkut te lojrave per femije dhe i fushes se sportit ne lagjen 5-shkurti	Bashkia Mallakaster	516,000	516,000	100
15	Kolaudim punimesh: reabilitimi ii parkut te lojrave per femije dhe i fushes se sportit ne lagjen 5-shkurti	Bashkia Mallakaster	42,918	42,918	100
16	Mbykqyrje punimesh per objektin: rikualifikimi urban i lagjes 28 nentori	FZHR	1,200,000	1,200,000	100
17	Mbikqyrje objekti:rikonstr dhe shtese kati nd bashkise	Bashkia Mallakaster	378,024	378,024	100
18	Rikonstruksion QKF	Bashkia Mallakaster	264,000	264,000	100
19	Blerje ,Cakull,Stabilizant,Steril Bituminoz per mirmbajtje rruge ne fshatra	Bashkia Mallakaster	47,889,316	30,000,000	63
20	Blerje peme dhe lule per zbukurim ambjente	Bashkia Mallakaster	5,829,870	0	0
21	Makine me Autovinc	Bashkia Mallakaster	948,000	948,000	100
22	Vendosje tapet bari ne ambjentet e jashteme te Bashkise	Bashkia Mallakaster	960,000	936,000	98
23	Aparate kondicionimi	Bashkia Mallakaster	360,000	358,200	100
25	Ndertim kuz lagja kurrizi Belishove	Bashkia Mallakaster	3,828,758	2,462,568	64
27	Rikonstruksion godina e MNZ	Bashkia Mallakaster	4,715,993	0	0
28	Sistemim i ngrohjes dhe ifrastruktura e bashkise	Bashkia Mallakaster	10,261,317	0	0



29	Mbikqyrje objekti: rikonstruksion shkolla 9 vjecare "beslidhja"	Bashkia Mallakaster	1,268,330	0	0
31	Rikonstruksion i rrugesve ne fshatra	Bashkia Mallakaster	56,948,892	0	0
32	MBIKQYRJE OBJEKTI ;Shtrese tapeti ne rruget e lagjes bylis,te bulevardit qendror deri te shkolla "odisea"	Bashkia Mallakaster	650,315	0	0
33	Kolaudim Objekti ;Shtrese tapeti ne rruget e lagjes Bylis,te bulevardit qendror deri te shkolla "odisea"	Bashkia Mallakaster	78,037	0	0
34	Kontributi per vitin 2018 i Bashkise Mallakaster per objektin: Rikonstruksion I shkolles 9 vjecare Beslidhja.	Bashkia Mallakaster	3,777,159	0	0
35	Blerje Piktura	Bashkia Mallakaster	950,400	950,400	100
36	Ndertim Depo Uji Per Vadtje Ambjente Te Gjebra	Bashkia Mallakaster	921,600	921,600	100
37	Berje Bust Gjok Doci	Bashkia Mallakaster	406,800	406,800	100
C	Investime nga financime te huaja		1,441,746	1,441,746	100
1	Rikonstruksion Tualetet shkolla Gj Doci	Ambasada Gjermane	1,441,746	1,441,746	100

Tabela: Numri i punonjësve

<i>Emërtimi I Programeve</i>	2018
	Numri i punonjësve të miratuar
<i>Administrimi ,Planifikimi dhe Menaxhimi</i>	144
<i>Menaxhimi i mbetjeve dhe sherbimet publike vendore</i>	33
<i>Mirmbajtje e rrugëve rurale</i>	
<i>Zhvillimi i sportit</i>	3
<i>Arti ,Kultura</i>	15
<i>Arsimi Baze dhe Parashkollor</i>	89
<i>Arsimi I mesem</i>	9
<i>Kujdesi Social (Cerdhja e femijeve)</i>	7
<i>Ujitja dhe kullimi</i>	1
<i>Administrimi i pyjeve</i>	25
<i>Rruget rurale</i>	82
<i>Sherbimi Zjarrfikës</i>	14
<i>Sherbimi i gjendjes civile</i>	7
TOTALI	429



6. MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

I. Programi: Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë Mallakastër dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për mbarëvajtjen e punës në përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në legjislacion.

Politika e Programit

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Bashkisë, të zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program gjatë vitit 2018 ka qenë 153,506 mijë lekë ose realizuar në masën 70%.

Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Programi: Planifikim, Menaxhim, Administrim					
Art.	Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	%
600	Paga	80,473,579	80,211,632	261,947	100
601	Sigurime Shoqërore	14,099,921	14,086,888	13,033	100
602	Mallra dhe shërbime të tjera	40,631,160	32,914,406	7,716,754	81
604	Transferta Korente të Brendshme	5,500,000	210,817	5,289,183	4
606	Transferta për Buxh. Fam & Individ	7,000,000	283,936	6,716,064	4
Nën-Totali	<i>Shpenzime Korrente</i>	<i>147,704,660</i>	<i>127,707,679</i>	<i>19,996,981</i>	<i>86</i>
230	Kapitale të Patrupëzuara	1,240,255	0	1,240,255	0
231	Kapitale të Trupëzuara	69,615,806	25,798,979	43,816,827	37
Nën-Totali	<i>Shpenzime Kapitale</i>	<i>70,856,061</i>	<i>25,798,979</i>	<i>45,057,082</i>	<i>36</i>
TOTALI		218,560,721	153,506,658	65,054,063	70



Për vitin 2018, ishin parashikuar arritja e disa objektivave në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë:

Kodi i Programit	0110	Planifikimi menaxhimi administrimi	
Qellimi 1	Zhvillimi i potencialit bashkiak për krijimin e një klime tërheqëse për investimet vendase dhe të huaja në Mallakastër, duke promovuar e mbështetur bashkëpunimin ndërkufitar me qëllim zhvillimin e biznesit dhe rritjen e mundësive për punësim.		
		**Treguesit e performancës/Produktet:	
	Objektivat e politikës:	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	% e Realizimit te Treguesit te Performance s/Produktit
Objektivi 1.1	Përgatitja e buxhetit vjetor dhe PBA	Paraqitja ne KB brenda afatit te percaktuar ne ligj dhe dorezimi i ketyre dokumnetave brenda afatit	100%
Objektivi 1.2	Menaxhimi i borxhit	Likujdimi i kredise sipas planit te pagesave	100%
Objektivi 1.3	Mbledhja e borxhit te krijuar 2011-2017	Gjate vitit 2018 eshte punuar per mbledhjen e borxhit	16%
Objektivi 1.4	Rritja e numrit te bizneseve me 5%	Regjistrime te reja te bizneseve e ka kaluar 5% e parashikuar	16%
Objektivi 1.5	Zgjidhja e ankesave te qytetareve	Hapja e sporteleve te reja dhe Bashkia e re ka krijuar lehtësira ne pritjen e qytetareve	100%

II. Programi: Sherbimi Mbrojtja ndaj Zjarrit dhe emergjencat civile

Politika e këtij program konsiston në mbështetjen dhe asistimin me punonjës të MNZ-së të Bashkisë në rastet e fatkeqësive natyrore apo raste të dëmtimeve nga zjarri.

Politika e programit

Politika e këtij programi konsiston në mbështetjen dhe asistimin me punonjës të MNZ-së në rastet e fatkeqësive të ndryshme natyrore apo raste të dëmtimeve nga zjarri.

Realizimi i shpenzimeve janar-dhjetor të vitit 2018 për këtë program, është 8,413 mijë lekë ose realizuar në masën 41% .


